



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE
Kërkime politike 2011/05

FUQIZIMI I SUNDIMIT TË LIGJIT NË KOSOVË II:
**KONFISKIMI I PASURISË SË FITUAR
NË MËNYRË TË KUNDËRLIGJSHME**

Prishtinë, prill 2011

Ky botim është realizuar me përkrahjen e Fondacionit të Vëllezërve Rockefeller (RBF).
Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e KIPRED-it.

Përgatitur nga: Ariana Qosaj-Mustafa dhe Adem Gashi

Edituar nga: Krenar Gashit

Copyright © 2011 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtrisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Luteni të kontaktoni: info@kipred.net apo +381 38 227 778.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

Rruga "Rexhep Mala", Nr 5A

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel dhe Fax: +381 38 227 778

www.kipred.net

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	5
2. Prapavijë e shkurtër.....	6
3. Korniza ligjore kosovare mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme	9
4. Qasjet rajonale ndaj konfiskimit të pasurisë të fituar në mënyrë të kundërligjshme.....	15
4.1 Shqipëria.....	17
4.2 Italia.....	18
5. Kapacitetet e tanishme në identifikimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme 19	
6. Menaxhimi i aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara.....	22
7. Përfundimi.....	23
8. Rekomandimet:	24
9. Referencat:	26

LISTA E SHKURTESAVE

AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar
AQB	Autoriteti Qendror Bankar
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KPPK	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
QIF	Qendra e Inteligjencës Financiare
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
AUV	Agjencia për Ushqim dhe Veterinari
KPGJP	Këshilli i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial
AKK	Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit
KIPRED	Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
MF	Ministria e Financave
MD	Ministria e Drejtësisë
APSK	Administrimi i Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZPSK	Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës

1. HYRJE

Tri vite pas shpalljes së pavarësisë, sundimi i ligjit mbetet pjesa më e brishtë e qeverisjes në Kosovë, e cila paraqet kërcënim për stabilitetin e vendit, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në perspektivën e tij sociale dhe ekonomike. Përderisa shkalla e papunësisë vazhdon të jetë rreth 45% dhe varfëria e skajshme mbi 15%, krimi i organizuar dhe korrupsioni i përhapur mbetin sfida më e madhe për shërbimet e dobëta gjyqësore e prokuroriale dhe për gjykatat e mbingarkuara.

Gjatë vitit 2010, Kosova filloi reformimin e sistemit gjyqësor. Këto ndryshime pritet të kenë efekt pozitiv në rritjen e efikasitetit dhe pavarësisë së sistemit gjyqësor, gjë që ka munguar gjatë viteve të fundit në këtë lëmi të shtetit.¹ Vetëm 60 % e pozitave të parapara për gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë janë plotësuar.² Aktualisht, Gjykata e Qarkut në Prishtinë vazhdon të ketë të punësuar vetëm 6 prokurorë në vend të 10, sa ishin të planifikuar,³ me 0.6 prokurorë publikë për 100,000 banorë. Prej janarit 2011, gjyqtarët dhe prokurorët kanë të ardhura më të larta, të ekuilibruara me nivelin ekzekutiv, me ç'rast i është rritur vlera vendit të tyre të punës. Me themelimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe me hyrjen në fuqi të ligjit, ka filluar pavarësimi i tij prej Ministrisë së Drejtësisë.

Numri i rasteve të dënuara të krimit të organizuar dhe korrupsionit është ende larg nga të qenit i kënaqshëm. Disa 'krime të lehta' të korrupsionit janë raportuar si të ndjekura dhe të dënuara, sidoqoftë, çka është më e rëndësishmja, përfshirja shpesh e raportuar e zyrtarëve të lartë në korrupsion dhe krim të organizuar mbetet e paprekur.⁴ Gjithsej, vetëm 15 raste të korrupsionit dhe 6 raste të krimit të organizuar janë raportuar si të dënuara nga misioni i EULEX-it deri më tani.⁵ Megjithatë, si për ironi, asnjë pronë e fituar në mënyrë të kundërligjshme në këto raste nuk është konfiskuar.

Gjatë periudhës 2008-2010 koalicioni qeverisës në Kosovë ka iniciuar procedura për sponsorimin e një ligji specifik anti-mafia, që do të rriste kapacitetet hetuese dhe do ta bënte

¹ Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2010 miratoi Ligjin mbi Gjykatat, Ligjin mbi Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ligjin mbi Prokurorinë Shtetërore dhe Ligjin mbi Këshillin Prokurorial të Kosovës. Shih Ligjin 03/L-199; Ligjin 03/L-223; Ligjin 03/L-225 dhe Ligjin 03/L-224 në <http://www.assembly-kosova.org/>.

² Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (IJPC) ka zhvilluar tri faza të procesit të emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve si pjesë e reformës së sistemit gjyqësor që ka përfunduar në tetor 2010. Raporti për punën e Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Prishtinë: tetor 2010.

³ Shih Raportin mbi Punën e Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës. Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Prishtinë: tetor, 2010.

⁴ Në raportin për Kosovën thuhet se ekziston një mospërputhshmëri e dukshme në mes të të hyrave dhe asetëve të poseduara nga zyrtarë të lartë në Kosovë, gjatë deklarimit të asetëve të tyre. Shih Raportin e Progresit 2010 për Kosovën, Komisioni Evropian. nëntor, 2010. Gjithashtu intervista për Radio Evropa e Lirë e Drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit - Hasan Preteni 'Korrupsion gjithandej' publikuar në <http://www.zeri.info/artikulli/1/2/20468/preteni-korrupsion-gjithandej/>

⁵ Komunikim përmes postës elektronike i KIPRED-it me Zyrën për Shtyp dhe Informim Publik , prill 2011.

më të lehtë për prokurorët të konfiskojnë asetet apo përfitimet e kundërligjshme nga aktivitetet kriminale. Kjo iniciativë kurrë nuk është zhvilluar më tutje. Ndërkohë, autoritetet gjyqësore dhe prokuroriale nuk kanë shfaqur asnjë plan konkret për zbatim të dispozitave të Kodit Penal (KPK) dhe Kodit të Procedurës Penale (KPPK) që kërkon konfiskimin e të mirave materiale të fituara nëpërmjet aktiviteteve kriminale.

Në këtë studim të veçantë, KIPRED-i fokusohet në zbatimin e ligjeve të tanishme mbi konfiskimin e përfitimeve nga krimi i organizuar dhe rastet e korrupsionit, fokusimin në kornizën e tanishme ligjore, aplikimin e procedurave, por gjithashtu edhe në praktikën e mira nga vendet tjera dhe rekomandimet konkrete se si të përmirësohet kjo vegël e rëndësishme për fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

2. PRAPAVIJË E SHKURTËR

Ligji i aplikueshëm në Kosovë ofron mundësi të mjaftueshme për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, edhe pse ka nevojë për avancim të mëtejshëm. Në veçanti, krijimi i Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës (ZPSK) në vitin 2008, ka ofruar kompetenca dhe juridiksion të detajuar për Prokurorët Specialë të përbërë nga shërbimi prokurorial vendor dhe ai i Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit (EULEX). Mandati i tyre në rastet e krimit të organizuar është i natyrës ekskluzive dhe duhet të konsiderohet si prioritet.⁶ Krimet e ndërlidhura me korrupsionin, përfshirë edhe ato të zyrtarëve publik janë të dorës së dytë. Vëmendje shtesë duhet të kushtohet kur ekziston interesi për zhvillimin e hetimit dhe ndjekjes. Interesi duhet të përcaktohet në kontekstin kosovar në rastet kur veprat e dyshuara kriminale e rrezikojnë funksionalitetin ose stabilitetin e shtetit ose të institucioneve publike.⁷ Zyra Speciale e Prokurorisë së Kosovës është mandatuar me një vendim të shumë-përfolur të Kryeministrit të Kosovës në shkurt të vitit 2010, për të krijuar një task-forcë kundër korrupsionit, të përbërë nga prokurorë dhe zyrtarë policorë, duke pranuar kështu nivelin e lartë të rasteve të korrupsionit në Kosovë. Vetë ky vendim

⁶ Neni 274 i Kodit Penal të Kosovës përkufizon krimin e organizuar. Veprimet e kundërligjshme të ndërlidhura me korrupsionin përfshijnë por nuk kufizohen në: Trafikimin me Njerëz (Neni 139) Keqpërdorimi i autorizimit në ekonomi (Neni 236); Pranimi i paarsyetueshëm i dhuratave (Neni 250); Dhënia e paarsyetueshme e dhuratave (Neni 251); Lidhja e kontratës së dëmshme (Neni 237) në veçanti paragrafi 2; Marrja e ryshfetit (Neni 343); Dhënia e ryshfetit (Neni 344) i Kodit Penal të Kosovës.

⁷ Neni 10, Paragrafi d i Ligjit mbi Zyrën e Prokurorisë Speciale në Kosovë Nr. 03/ L-052.

ndërhynte në pavarësinë e hetimeve dhe ndjekjeve. Rezultatet e përgjithshme të Task-forcës janë minimale,⁸ edhe pasi ka kaluar gati një vit e gjysmë nga themelimi i saj.

Policia gjyqësore e paraparë me Kodin Penal të Kosovës nuk është krijuar ende, gjë që paraqet një mungesë të madhe për sistemin. Deri në vitin 2010, hetimi dhe ndjekja e zyrtarëve të lartë të dyshuar për vepra korruptive ishte caktuar si prioritet nga misioni i ESDP-së në Kosovë. Sidoqoftë, rezultatet kanë qenë të pakta deri tani, me një numër të vogël të dënimit të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Tashmë janë bërë dy vite e gjysmë që nga fillimi i misionit të EULEX-it. Një gjyqtar i EULEX-it ka shqiptuar mesatarisht 1.78 dënime në vit.⁹ Në lidhje me ndjekjen dhe dënimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, një prokuror i EULEX-it ka hetuar dy raste të korrupsionit dhe një rast që ka të bëjë me krimin e organizuar, ndërsa një gjyqtar i EULEX-it, mesatarisht ka shpallur 0.17 aktgjykime për rastet e korrupsionit dhe 0.07 aktgjykime për rastet e krimit të organizuar në vit.

Ligji i aplikueshëm në Kosovë është i kufizuar në qasjen e tij ndaj luftës kundër korrupsionit derisa kompetenca e prokurorëve specialë në kuadër të ZPSK për raste të tilla është e dorës së dytë. Prandaj është e nevojshme që ZPSK në koordinim me Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), të punojë e pavarur nga interferencat e jashtme qeveritare në krijimin e task-forcës së saj dhe në koordinimin e rasteve me Prokurorinë Shtetërore të Kosovës. Ndërkohë, Prokurori Shtetëror duke e parë këtë nevojë, ka krijuar një grup pune kundër korrupsionit të përbërë nga prokurorë të nivelit komunal dhe atij të qarkut. Prokurorët e emëruar duhet t'i kenë prioritet të veçantë rastet e korrupsionit. Koordinatori kundër korrupsionit, që i raporton Prokurorit Shtetëror, ende nuk ka zhvilluar regjistrin për evidentim të rasteve të hetuara, të ndjekura dhe të dënuara.¹⁰ Këto mekanizma të mëdha paraqesin sfida në koordinimin e punës efektive në luftën kundër korrupsionit në Kosovë. Mungesa e kompetencave ekskluzive të ZPSK në rastet e korrupsionit dhe mungesa e mbështetjes me kapacitete njerëzore, financiare dhe logjistike për prokurorët specialë, vazhdon ta pengojë efikasitetin e punës së tyre.

⁸ Së fundi, Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës ka raportuar se 73 raste kanë qenë nën hetime nga zyra për veprimet e kundërligjshme të ndërlidhura me korrupsionin, përfshirë këtu edhe ato të zyrtarëve të lartë publikë. [Koha Net. Prokuroria Speciale heton 73 raste të korrupsionit](http://www.koha.net/index.php/force_download/?cid=1.22.55527). Mund të gjendet në http://www.koha.net/index.php/force_download/?cid=1.22.55527 (e qasur me 20 Prill, 2011).

⁹ Komunikim përmes postës elektronike në mes të KIPRED-it dhe Zyrës për Shtyp dhe Informim Publik, EULEX, 26 prill, 2011

¹⁰ Intervista e KIPRED-it me Drita Hajdari, Koordinator kundër korrupsionit në Zyrën e Prokurorit Shtetëror, prill 2011.

Kohëve të fundit, Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit (AKK)¹¹ ka raportuar se vazhdojnë sjelljet e dyshimta korruptive të zyrtarëve të lartë në Kosovë. Janë 43 zyrtarë të lartë publikë në Kosovë tek të cilët është vërejtur një mospërputhje e qartë në deklarimin e të ardhurave dhe pasurisë në Dyzet e tre (43) zyrtarë të lartë publik në Kosovë kanë pasur mospërputhje të qartë në mes të deklaratave të të ardhurave dhe pasurisë që i kanë dhënë AKK dhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, para zgjedhjeve parlamentare të mbajtura në Dhjetor të vitit 2010. Të ardhurat e deklaruara në Agjenci dhe në KQZ dallojnë thelbësisht. Komisioni Evropian, në raportin e tij të vitit 2010 për Kosovën, ka cekur se ende ka korrupsion në nivelet e larta në Kosovë,¹² derisa AKK vazhdon të ketë kapacitete të kufizuara hetuese. AKK mundet vetëm të kërkojë nga gjykatat t'i konfirmojnë deklaratat e rrejshme nga zyrtarët dhe të raportojë në gjykatë rastet¹³, të cilave mund tu shqiptohet gjoba prej 150 deri 1500 Euro.

Përveç këtyre iniciativave, Kosova mbetet në gjysmë të rrugës me ligjet e saj, rregulloret dhe mekanizmat për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, dhe regjistrimin e rasteve të hetuara dhe të ndjekura brenda vitit. Gjithsej 15 raste të korrupsionit dhe 6 raste të krimin të organizuar janë raportuar nga misioni i EULEX-it. Situata i ngjan një status quo-je, për shkak të krizës institucionale dhe politike që filloi me dorëheqjen e Presidentit të Kosovës në tetor të vitit 2010, e që rezultoi me zgjedhjet parlamentare në dhjetor të vitit 2010 dhe zgjedhjen e qeverisë së re në shkurt të vitit 2011. Disa nga ministrat e qeverisë së kaluar ishin shpallur nën hetim për korrupsion në mënyrë sensacionale, për shkak të dyshimit për keq-menaxhim të miliona eurove nga buxheti i Kosovës. Asnjë nga këto hetime nuk rezultoi me ngritjen e akuzave, përderisa njërit nga ish-ministrat ndërkohë iu ngrit edhe akuza për krime lufte nga prokurorët e EULEX-it.

Kjo situatë e status quo-s i është atribuar mungesës së vullnetit politik, dhe ndikimeve politike në sistemin gjyqësor të Kosovës.¹⁴ Personat e përfshirë në aktivitete korruptive ose personat “e pasuruar brenda natës”, janë shndërruar në një brengë të madhe për ekonominë e vendit dhe menaxhimin e fondeve publike.¹⁵ Jo-efikasiteti i ligjeve është drejtpërsëdrejti i lidhur me sistemin e dobët gjyqësor, i cili ka qenë i tillë me vite, me ngurrimin e gjyqtarëve

¹¹ Shih raportin vjetor 2010. Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit. Mund të gjendet në http://www.akk-ks.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_2010_janar_dhjetor.pdf (e qasur me 20 prill, 2011).

¹² Shih Raportin e Progresit 2010 për Kosovën, Komisioni Evropian. nëntor, 2010.

¹³ Shih Ligjin mbi Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë dhe Dhuratat e Zyrtarëve të Lartë Publikë, Kapitulli IV dhe V, që mund të gjendet në <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-151-eng.pdf>.

¹⁴ Nations in Transit ka vazhduar vlerësimin e Kosovës për nivelin e korrupsionit me 6.00 ose 5.75, që është vlerësimi më i ulët krahasuar me vendet fqinje. Shih Nations in Transit, Raporti për Kosovën, 2010.

¹⁵ Deklarata e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit në konferencë për shtyp, publikuar në raportin vjetor 2010, mars 2011.

dhe prokurorëve publik t'i zbatojnë ligjet ekzistuese si dhe me korrupsionin e përhapur në nivele të ndryshme të qeverisjes në Kosovë.

Prandaj, KIPRED ka bërë këtë analizë në mënyrë që ta përcaktojë nivelin e gatishmërisë së institucioneve të Kosovës për hetim, ndjekje dhe dënim të krimit të organizuar dhe delikteve korruptive në Kosovë duke analizuar thellësisht kapacitetet e këtyre institucioneve për konfiskim të pasurisë së fituar nga aktivitetet e kundërligjshme. Kjo analizë është ndërmarrë që të kërkojë vendsojen e ligjeve efikase, dhe zbatimin e ligjeve ekzistuese në Kosovë, me synim fuqizimin e sundimit të ligjit.

3. KORNIZA LIGJORE KOSOVARE MBI SEKUESTRIMIN DHE KONFISKIMIN E PASURISË SË FITUAR NË MËNYRË TË KUNDËRLIGJSHME

Konfiskimi i aseteve të fituara nëpërmjet kryerjes së veprave penale është vegël e shkëlqyeshme për sanksionimin e kriminelëve dhe njëkohësisht për kompensim nga shteti, të dëmeve të krijuara. Në çdo krim ekziston një palë e dëmtuar ose viktimë që mund të jetë/jenë individ/ë ose subjekt juridik. Prandaj, shoqëria si tërësi ka interes të madh në konfiskimin e aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme nga kriminelë të dyshuar apo të dënuar, në mënyrë që të kompensojë dëmet e shkaktuara. Përfituesit e konfiskimit nuk kufizohen vetëm në viktimat e drejtpërdrejta. Këta më shumë mund të jenë grupe të marginalizuara apo grupe që i shërbejnë interesit publik, që përfshijnë persona me aftësi të kufizuara, të varfrit, madje edhe organizata të shoqërisë civile që kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve për shtetin ose janë drejtpërsëdrejti të përfshira në luftën kundër aktiviteteve kriminale. Ligji i aplikueshëm i Kosovës ka paraparë një qasje të ngjashme kur ka paraparë kompensimin e dëmeve për viktimat e trafikimit nëpërmjet ngritjes së “Fondit për Reparacionet e Trafikimit”, fond ky që do të financohej nga përfitimet e konfiskuara të trafikimit.¹⁶ Sidoqoftë, ky legjislacion specifik kurrë nuk gjeti zbatim në Kosovë, sikurse që kurrë nuk u plotësua pozita e “Koordinatorit për Ndihmë të Viktimave”¹⁷ dhe nuk u themelua fondi për dëmshpërblim nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë.

¹⁶ Shih Udhëzimin Administrativ të UN-it 2005/03 Nr. 2005/03 Zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut 2001/04 mbi Ndalimin e Trafikimit me Njerëz në Kosovë, në http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/02english/E2005ads/ADE2005_03.pdf.

¹⁷ “Koordinatori për Ndihmë të Viktimave” është dashur të emërohet nga Ministria e Drejtësisë me qëllim të koordinimit të ndihmës dhe dëmshpërblimit të viktimave të trafikimit, përfshirë këtu fondet e mbledhura nga konfiskimi i pasurisë së krijuar përmes trafikimit. Shih Udhëzimin Administrativ të KB 2005/03 Nr. 2005/03 Zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut 2001/04 mbi Ndalimin e Trafikimit me Njerëz në Kosovë.

Siç u tha, ligji i aplikueshëm në Kosovë përmban dispozita që kërkojnë konfiskimin e të mirave materiale të fituara përmes kryerjes së veprave penale.¹⁸ Mbledhja e informatave mbi burimin e pasurive të mëdha personale është dëshmuar te jetë e vështirë në Kosovë.¹⁹ Përfaqësuesit e zbatimit të ligjit e mbajnë barrën për të ofruar dëshmi dhe për të verifikuar provat dhe ndjekja penale shihet si sfidë kryesore²⁰ dhe si pasojë e bën problematik zbatimin e ligjit.

Sistemi ligjor i Kosovës ofron dispozita që i mundësojnë prokurorëve dhe gjyqtarëve që pas vendimit gjyqësor, të konfiskojnë pasurinë e fituara përmes aktiviteteve të kundërligjshme. Këto pasuri përfshijnë ‘...të gjitha të hollat, gjësendet me vlerë dhe përfitimet tjera material/e të fituara përmes kryerjes së veprës penale...’²¹ dhe duhet të konfiskohen nga kryerësi i veprës penale. Në rastet kur konfiskimi nuk është i mundur, personi i dënuar duhet të urdhërohet që të paguajë shumën e të hollave në barasvlerë me të mirat materiale të fituara. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale në Kosovë përmbajnë një kapitull të veçantë i cili përkufizon çka, kush, kur, dhe si mund të konfiskohet pasuria.²² Prokurorët dhe gjyqtarët janë të obliguar të hetojnë, sekuestrojnë apo konfiskojnë pasuritë në bazë të Kapitullit 7 të Kodit Penal të Kosovës. Më tej, gjykata nuk kufizohet në konfiskim vetëm të posedimeve të kryerësit, por mund të konfiskojnë të mira materiale²³ të cilat u janë transferuar pa kompensim çfarëdo pale tjetër.

**PAS VENDIMIT
GJYQESOR, GJYKATAT
KOSOVARE MUND TË
KONFISKOJNE CDO TË
MIRË MATERIALE TË
PËRFITUAR NGA
KRYERJA E VEPRAVE
PENALE**

Megjithëse ky legjislacion ekziston tashmë disa vite, hulumtimet e KIPRED-it nuk kanë zbuluar asnjë rast të raportuar të konfiskimit të përfitimeve nga krimet. Prokurorët dhe gjyqtarët kanë neglizhuar masa të tilla pasi që këtë jo-efikasitet ia kanë atribuuar mungesës së mundësive ligjore për konfiskim.²⁴ Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) nuk ka mbledhur të dhëna mbi aplikimin e neneve 54, 82, 83, 84, ose 85 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), që janë të lidhura me konfiskimin e të mirave materiale të fituara nga veprat penale.²⁵ Gjyqtarët dhe prokurorët e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të cilët kanë të bëjnë me 50% të të gjitha

¹⁸ Shih Kodin Penal të Kosovës, Kapitulli 7 mbi Konfiskimin e Dobisë Pasurore të fituar përmes Kryerjes së Veprave Penale.

¹⁹ Intervistat e KIPRED-it me Kryetarin e Gjykatës Supreme, hetuesit dhe gjyqtarët e EULEX-it, shkurt 2011.

²⁰ Ibid. Gjithashtu edhe me Prokurorin Special të Kosovës dhe Drejtorin Ekzekutiv të AKK, shkurt dhe mars 2011.

²¹ Shih Kodin Penal të Kosovës, Neni 83.

²² Shih Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, Kapitulli 44 mbi Procedurën për Konfiskim.

²³ Ibid.

²⁴ Intervistat e KIPRED-it me gjyqtarë dhe prokurorë, mars-prill 2011.

²⁵ Komunikim përmes postës elektronike në mes të KIPRED-it dhe Zyrës për Statistika, KGJK, 14 prill, 2011.

rasteve të iniciuara në gjykatat e qarkut,²⁶ kurrë nuk kanë pasur ndonjë rast që ka përfshirë konfiskimin e këtij lloji të përfitimeve materiale. Më tej, zyrat e prokurorisë publike nuk kanë të dhëna²⁷ për prokurorët që kanë kërkuar konfiskimin e aseteve.

Megjithëse gjykatat kanë shpallur vendime në rastet e krimit të organizuar në trafikim të njerëzve, konfiskimi i aseteve ose përfitimeve nga krimet, siç janë hotelet ose të hollat e fituara përmes trafikimit,²⁸ kurrë nuk është urdhëruar nga gjyqtarë të Kosovës apo EULEX-it, përkundër faktit se ligji lejon konfiskimin ose zbatimin e masave të përkohshme kur shqiptohen dënimet për vepra penale.²⁹

Strategjia aktuale e qeverisë parasheh hartimin e ligjit mbi parandalimin e krimit të organizuar.³⁰ Duket se ekziston vullnet politik për të hartuar disa ligje, por jo për të ndërtuar mbi legjislacionin ekzistues dhe mangësitë e identifikuara në luftimin efektiv të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ekzistimi i disa ligjeve dhe mekanizmave deri më tani nuk ka adresuar hartimin e ligjeve specifike, si ai mbi konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme apo të ligjit për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ndryshe, qartësimi i dispozitave në kodin penal do të mund të përmirësonte ndjekjen efektive dhe shqiptimin e dënimit në këto raste.

Dështimi kryesor i infrastrukturës së tanishme ligjore konsiderohet të jetë përgjegjësia për ofrim të dëshmive që bie mbi shërbimet prokuroriale dhe ato të zbatimit të ligjit. Gjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit thonë se është e vështirë të mbledhin të dhëna të mjaftueshme për të dëshmuar se asetet e caktuara janë krijuar përmes aktiviteteve të kundërligjshme. Prokurorët thonë se ndodh që ata të mbledhin të dhëna vetëm për një rast të veprës penale, ndërsa personi i dënuar mund të ketë qenë i përfshirë në aktivitete kriminale për një periudhë më të gjatë kohore. Hetimet e rasteve të korrupsionit në të cilat janë të përfshirë zyrtarë të lartë mbesin tejet të komplikuar dhe duket se ekziston mungesë e vullnetit për t'i marrë këto raste.³¹ Arsyeimi i dhënë për këtë është se legjislacioni i tanishëm kufizon prokurorët dhe gjyqtarët, pasi që ata nuk janë në gjendje të aplikojnë masat e parapara për konfiskim të pasurisë së krijuar duke u bazuar në një aktivitet të vetëm kriminal të personit. Duket se zhvillimi i operacioneve të fshehta dhe teknikave hetuese nuk ekziston, bazuar në nivelin aktual të performancës së institucioneve. Në përgjithësi, duket se mungon vullneti për të

²⁶ Intervista e KIPRED-it me Administratorin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, 6 prill, 2011.

²⁷ Komunikim përmes postës elektronike në mes të KIPRED-it dhe Zyrës së Prokurorit Shtetëror dhe Ministrisë së Drejtësisë, 6 prill, 2011.

²⁸ Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2001/04 mbi Ndalimin e Trafikimit me Njerëz në Kosovë, kapitulli II mbi hetimin, konfiskimin dhe procedurat gjyqësore.

²⁹ Shënimi i mësipërm në 28.

³⁰ Shih Strategjinë Legjislative 2011, Zyra e Kryeministrit.

³¹ Intervista e KIPRED-it me një gazetar të specializuar për çështjet gjyqësore, prill 2011.

shfrytëzuar mundësitë e ligjit të aplikueshëm, në rastet ku kemi të bëjmë me sjellje tejet komplekse korruptive, përfshirë këtu edhe ato të zyrtarëve të lartë.

Për më tepër, gjykatat mund të aplikojnë masa të konfiskimit për asetet vlera e të cilave përputhet me dëshmitë të cilat prokurorët kanë mundur të mbledhin, e që mbetet e kufizuar dhe vlerësohet si tejet e komplikuar nga prokurorët. Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Kryetari i Gjyqtarëve të EULEX-it kanë deklaruar se dispozitat e tanishme ligjore paraqesin një pengesë për gjykatat në konfiskimin e aseteve të gjeneruara nga aktivitete kriminale, pasi që prokurorët po dështojnë në zbatimin e ligjit të aplikueshëm ose nuk janë në gjendje të ofrojnë dëshmi të mjaftueshme.³² Nëse do të kishte ndryshim në sistemin e përgjegjësisë për ofrim të dëshmive, e cila do të binte mbi kryerësin, prokuroria do të mund të hetonte mënyrën se si personi ka gjeneruar përfitime materiale, përfshirë këtu asetet që janë pronë e anëtarëve të ngushtë të familjes apo ato të transferuara tek personat e tjerë, duke i kërkuar të dyshuarit të ofrojë dëshmi për prejardhjen e pasurisë së tij.

Kjo do të mund t'u jepte fund kriminelëve, të cilët pavarësisht problemeve në të cilat kanë hasur me ligjin, vazhdojnë të gëzojnë të mirat materiale të përfituara përmes aktiviteteve kriminale dhe rritjen e papritur të pasurisë së tyre nga aktivitetet e kundërligjshme.

Zhvillimet tjera: Gjatë 2010-tës, Kryeministri i Kosovës, inicioi një debat dhe premtoi se Zyra e Kryeministrit do të sponsorizonte një ligj anti-mafia në mënyrë që ta bëjë më të lehtë për organet e drejtësisë të konfiskojnë asetet kriminale. Ideja e forcimit të legjislacionit mbi konfiskimin mund të shihet si esenciale, por ka pasur dyshime rreth përkushtimit të premtuar për shkak të vonesave në fillimin e hartimit të ligjit dhe në përgjithësi dispozitave dhe sanksioneve të dobëta të sjella deri më tani me legjislacionin kundër korrupsionit. Më tej, autoritetet e zbatimit të ligjit në Kosovë dhe shërbimet e tyre gjyqësore dhe prokuroriale kanë bërë përpjekje të mëdha për shpërbërjen e rrjeteve të krimit të organizuar dhe paraqitjen e dëshmive për këto raste në gjykata. Nuk është e sigurtë se sa janë në gjendje të përkufizojnë dhe dëshmojnë natyrën komplekse të grupeve mafioze institucionet e Kosovës me kapacitetet dhe punën e tyre të deritanishme.

Strategjia e tanishme legjislativë e Zyrës së Kryeministrit ka përfshirë punën në draft ligjin mbi Parandalimin e Krimit të Organizuar në Kosovë, i cili do të duhej të miratohej kah fundi i vitit 2011. Nga iniciativa nuk është e qartë se cili do të jetë qëllimi i ligjit dhe si përkufizohet saktësisht parandalimi. Zbrazëtirat domethënëse të pranishme në ligjet tjera paraqesin një brengë se një gjë e tillë eventualisht do të duhet të adresohet. Në veçanti, ekzistimi i shumë

³² Intervista e KIPRED-it me Z. Fejzullah Hasani, Kryetar i Gjyqit Suprem të Kosovës, 21 mars, 2011 dhe Znj. Maria Juliana Civinini, Kryetare e Gjyqtarëve të EULEX-it, 16 mars, 2011

ligjeve, mekanizmave dhe sanksioneve të dobëta brenda kornizës ekzistuese ligjore, e bën edhe më të vështirë të kuptuarit dhe zbatimin e iniciativave të tanishme.

Për shembull, Ligji i tanishëm për Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë parasheh sanksione të vogla për zyrtarët të cilët nuk i plotësojnë formularët e deklarimit ose japin deklarata të rreme. Edhe pse ligji është i paqartë për sa i përket procedurave të kontrollit të autenticitetit të pronave të paraqitura, sanksionet e parapara luajnë nga 150 Euro deri në 1500 Euro. Kapaciteti aktual i hetuesve në AKK është gjithashtu i kufizuar, ku Departamenti i Hetimeve aktualisht ka të punësuar vetëm 12 hetues. Adresimi i korruptimit të zyrtarëve të lartë me legjislacionin aktual duket më shumë simbolik, bazuar në efektet të cilat ligjvënësit deklarojnë se janë arritur.

Deklarimi i pasurisë i prezantuar për zgjedhjet parlamentare në 2010 nga kandidatët politikë dhe deklarimi i pasurisë i prezantuar në vitin 2010 në AKK pasqyron një rritje të palogjikshme të pasurisë për disa politikanë.³³ Zyrtarë të AKK-së deklarojnë se kjo mospërputhje në mes të deklarimit të pasurisë që politikanët kanë dorëzuar në AKK dhe në KQZ, të dorëzuara brenda një kohë të shkurtër kohore, paraqet një brengë të madhe.

Mosplotësimi i formularëve për deklarim të pasurisë apo paraqitja e të dhënave të rreme për pasurinë dhe të ardhurat nga zyrtarët e lartë sanksionohet si kundërvajtje që bartë dënime minimale.³⁴ KIPRED gjithashtu ka analizuar ndryshimet në deklaratat financiare të dorëzuara në KQZ. Këto përfshijnë, por nuk janë të kufizuara, në politikanët të cilët kanë deklaruar se nuk kanë pasur para të gatshme apo të holla të depozituara në banka, dhe politikanë të cilët kanë pasur vetëm tre mijë euro të depozituara në banka, ndërsa gjashtë muaj më vonë kjo shumë është rritur në mbi njëqind mijë euro pa asnjë shpjegim logjik për një rritje të tillë. Ka pasur politikanë paga vjetore e të cilëve është zvogëluar, ndërsa pasuria e tyre financiare është rritur deri në 100% brenda tre vjetëve. Megjithëse ka mospërputhje të dukshme në rritje të tillë të pasurisë, kanë munguar aktivitetet hetuese të cilat do të zbulonin të vërtetën mbi mospërputhjet në deklaratat financiare të politikanëve, dhe tash zyrtarëve të lartë publikë. Mbetet e paqartë se si do të vazhdojnë më tej këto raste³⁵, pasi që deri më tani nuk ka pasur hetime të inicuar nga prokurorët mbi këtë bazë.

³³ Zyrtarët e lartë të cilët punojnë në të gjitha institucionet shtetërore përfshirë këtu, por jo duke u kufizuar në institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore, Agjencitë e Pavarura, Gjykatat, Ndërmarrjet Publike, Presidenca, dhe Kuvendi i Kosovës, deklarojnë pasurinë e tyre dhe të ardhurat në baza vjetore. Shih Ligjin mbi Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë, në Kuvendin e Kosovës.

³⁴ Intervista me Drejtorin Ekzekutiv të AKKK Z. Hasan Preteni, shkurt 2011.

³⁵ Intervista e KIPRED-it me Znj. Drita Hajdari, koordinatore kombëtare kundër korruptimit në Zyrën e Prokurorit Shtetëror, prill 2011 dhe Prokurorin Special të ZPSK (mars 2011).

KIPRED më tej ka përzgjedhur një mostër të rastësishme prej 14 anëtarëve të parlamentit që kanë dorëzuar deklaratat e tyre të pasurisë në AKK gjatë 2010-tës, dhe ka analizuar pasurinë, të ardhurat dhe detyrimet e tyre. Duket se pjesa më e madhe e pasurisë, apo 63% e saj, është trashëguar ose është pasuri e përbashkët familjare, ndërsa vetëm 34% e pasurisë është blerë direkt nga politikanët përmes kursimeve të tyre, kredive, apo shitjes së ndonjë pasurie tjetër.

Prejardhja e pasurisë:

E trashëguar ose e përbashkët me anëtarët e tjerë të familjes	€ 2,279,000	63%
E blerë përmes kursimeve ose shitjes së ndonjë prone tjetër	€ 1,127,640	31%
Para (të gatshme ose llogari bankare)	€ 108,949	3%
Kredi (e përdorur për të blerë ndonjë pronë shtesë ose e kursyer në bankë)	€ 126,400	3%
GJITHSEJ:	€ 3,641,989	100%

Të ardhurat mesatare vjetore të çdo zyrtari ishin rreth 24.000 Euro, përderisa mesatarisht çdo zyrtar ka pronë dhe para në vlerë prej 97.000 Eurosh, duke përjashtuar këtu pasurinë e trashëguar apo të përbashkët me anëtarët e familjes. Në bazë të këtyre shifrave, dikush do të mund të supozonte se këta anëtarë të parlamentit duhet të shpenzojnë të gjitha të ardhurat për të blerë pronë në vlerë prej 97 mijë Euro brenda katër vitesh. Pasi që njerëzve iu duhen të ardhurat e tyre për të jetuar, është evidente se këto prona të deklaruara janë jo proporcionale dhe të dyshimta.

Shembulli i mësipërm paraqet disa nga çështjet të cilat duhet të ngriten nga prokuroria dhe organet e zbatimit të ligjit për sa i përket deklarimeve të bëra nga zyrtarë të lartë publikë. Mospërputhja në mes të të ardhurave dhe pronës së poseduar duhet të hetohet duke përdorur analiza të bazuara në inteligjencë dhe qasje të tjera hetimore.

Nëse deklarimet e rreme të aseteve sanksionohen si vepër penale me Kodin Penal të Kosovës, i cili aktualisht është duke u amandamentuar nga Ministria e Drejtësisë, kjo do të dëshmonte vullnetin e vërtetë për të adresuar përfshirjet e mundshme të zyrtarëve të lartë në afëra korruptive gjatë viteve të fundit. Gjithashtu do të bëhej e dhënë e rëndësishme kundër zyrtarëve të dyshuar për përfshirje në aktivitete të ndërlidhura me korrupsionin. Ligji do të përmirësonte rolin e AKK-së, në mënyrë që kjo agjenci të jetë në gjendje të zhvillojë hetime profesionale në pasuritë e deklaruara nga zyrtarët e lartë. Aktualisht, AKK ka dorëzuar këto deklarata që kanë mospërputhje në Njësinë e Inteligjencës Financiare dhe në komisionin disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në rastet kur AKK ka burime të kufizuara për të

hetuar më tej deklaratat e të gjithë zyrtarëve, do të ishte e këshillueshme që rastet të dërgohen menjëherë në prokurori dhe Agjencia të bëjë auditimin dhe hetimin e atyre rasteve që paraqesin rrezik më të madh për keqpërdorim të pozitës publike.

Korniza e tanishme ligjore përmban dispozita të kufizuara dhe të paqarta mbi konfiskimin e pasurisë që buron nga të ardhura të ligjshme dhe pasurisë së përfiturar të deklaruar. Disa institucione në Kosovë do të duhej të vazhdonin me zbatimin e dispozitave ekzistuese për t'u angazhuar në kërkim dhe hetim të këtyre çështjeve derisa ligjet e nevojshme të hyjnë në fuqi, siç është ligji mbi luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe ndryshimi i përgjegjësisë së ofrimit të dëshmisë. AKK do të mund të iniciojë kërkime preliminare për të identifikuar dhe raportuar në zyrat e prokurorisë publike për rastet më të dyshimta të lidhura me mospërputhje në mes të të ardhurave të ligjshme dhe pasurisë së poseduar. Më tej, AKK do të mund të identifikonte rastet e rritjes së palogjikshme të pasurisë së zyrtarëve përgjatë viteve. Përmes kësaj metode, prokurorët publikë dhe Policia e Kosovës do të mund të kërkonte udhëheqjen e hetimeve të bazuara në inteligjencë mbi aktivitetet e këtyre zyrtarëve. Nëse gjetjet tregojnë se zyrtarët janë të përfshirë në aktivitete kriminale ose kanë kryer vepra penale, prokurorët do të mund të iniciojnë këto raste në gjyq dhe të kërkojnë konfiskimin e pasurisë duke u munduar të mbledhin fakte të mjaftueshme për të bërë lidhjen në mes të aktiviteteve kriminale dhe rritjes jo proporcionale të pasurisë. Më tej, rritja e palogjikshme e pasurisë së zyrtarëve bie gjithashtu në mandatin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), e cila mund të angazhohet në zhvillimin e kërkimeve mbi evazionin tatimor ose mashtrimet në bizneset që ndodhen në pronësi të zyrtarëve.

4. QASJET RAJONALE NDAJ KONFISKIMIT TË PASURISË TË FITUAR NË MËNYRË TË KUNDËRLIGJSHME.

Derisa rastet e krimit të organizuar janë shpesh të natyrës tej-nacionale dhe mund të bëjnë presion mbi stabilitetin e vendeve³⁶, disa vende janë shtyrë që të sjellin ligje specifike në lidhje me këtë fenomen, përfshirë edhe mundësinë e të kërkuarit që shkelësi ta demonstrojë origjinën e ligjshme të fitimeve të dyshuara si kriminale. Italia ka zhvilluar mekanizma të avancuara për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Vendet fqinje si Shqipëria, Serbia dhe Kroacia kanë adaptuar ligje të veçanta në mënyrë që t'i ndihmojnë prokurorët në konfiskimin e aseteve.

³⁶ Konventa e OKB-së e 12 dhjetorit 2000 Kundër Krimit të Organizuar Tej-nacional, Neni 12 mbi marrjen dhe konfiskimin. Shiko edhe Vendimin e Kornizës Punuese të Këshillit 2005/212/JHA i 24 shkurtit 2005 mbi Konfiskimin e Fitimit të lidhur me Krimin. Instrumentet dhe Fitimet, paragrafi (6).

Për shembull, modeli kroat mbështetet në procedurën penale për konfiskimin e aseteve pasi që të jetë shpallur verdikti mbi fajësinë. Konfiskimet e përkohshme lejohen, por për një kohë të kufizuar. Kroacia ka avancuar Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale duke kaluar ligje që kanë të bëjnë me Zyrën e Prokurorisë Speciale që ka për detyrë të luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar.³⁷ Ai gjithashtu mundëson bartjen e përgjegjësisë së ofrimit të dëshmive tek i dyshuari në rastet e veçanta që drejtohen nga zyra e USKOK p.sh. korrupsion dhe krim i organizuar. Kjo qasje është shfrytëzuar për të siguruar ndjekje efektive të rasteve penale. Në mënyrë që të konfiskojë dhe të garantojë sekuestrimin e pasurisë së rrjedhur nga pasuria e fituar në mënyrë të kundërligjshme në rastet e korrupsionit dhe krimin të organizuar, është kaluar një ligj i veçantë mbi konfiskimin apo sekuestrimin.³⁸ Edhe Maqedonia ka amandamentuar Kodin e saj Penal duke zgjeruar grupin e njerëzve prej të cilëve autoritetet shtetërore mund të konfiskojnë asetet e fituara me anë të aktiviteteve të kundërligjshme. Gjatë vitit 2008, Serbia ka kaluar Ligjin mbi Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Fitimit nga Krimi, duke qartësuar procedurat për sekuestrim dhe konfiskim, pasi prokurorët të kenë ofruar dëshmi për dyshimet e tyre në lidhje me mospërputhjet mes pasurisë së një personi dhe të ardhurave të tij. Kosova deri tani nuk ka legjislacion specifik mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar me aktivitete kriminale, sidoqoftë ajo e ka kaluar ligjin mbi krijimin e agjencisë përgjegjëse për menaxhimin e këtyre aseteve. Kodi Penal dhe ai i Procedurës Penale e adresojnë këtë çështje, por megjithatë mbesin të kufizuar në sqarimin e procedurave që duhet të ndërmerren nga gjykatat dhe prokurorët. Prokurorët e Kosovës e arsyetojnë mungesën e aplikimit të ligjit të aplikueshëm³⁹ me mungesën e qartësisë së procedurës në rastet e korrupsionit.

Ekzistojnë disa ngjashmëri me shtetet që kërkojnë që legjislacioni të jetë mjaft i detajuar në atë se çka konsiderohet si provë se asetet janë të fituara përmes veprave penale apo aktiviteteve të dyshuara si të kundërligjshme. Specifikohet edhe kohëzgjatja e sekuestrimit të këtyre aseteve, si në modelin kroat, që nuk lejon sekuestrimin të zgjasë më shumë se dy vite.⁴⁰ Vërehet se shtetet e rajonit që kanë filluar të përfitojnë nga konfiskimi i fitimit të arritur në mënyrë kriminale, kanë mundësi të detajuara të hetimit, ndjekjes dhe dënimit të krimin të organizuar në ligje të veçanta. Këto ligje gjithashtu përfshijnë në detaje procedurat e konfiskimit të fitimit nga aktivitetet kriminale. Si në rastin e ligjit kroat, detyrat,

³⁷ Ligji mbi zyrën për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar http://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2009_07_76_1834.html

³⁸ Ligji mbi procedurën për konfiskimin e fitimit nga aktivitetet kriminale, NN145/10, i kaluar me 24.12.2010.

³⁹ Intervista me Prokuroren e Kosovës Znj. Drita Hajdari, Zyra Koordinuese e Prokurorisë Shtetërore Kundër Korrupsionit, prill 2011.

⁴⁰ Shënimi i mësipërm në 24.

përgjegjësitë, dhe struktura organizative e njësive speciale hetuese janë të përfshira në një ligj që trajton rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

4.1 Shqipëria

I ashtuquajtur Ligji Shqiptar Anti-Mafia⁴¹ ka paraparë masa që lejojnë sekuestrimin e aseteve me anë të procedurës civile. Ligji ka hyrë në fuqi edhe pse Kodi Penal Shqiptar lejon konfiskimin e pasurisë kur ajo është pjesë e dënimit. Ligji Anti-Mafia është aprovuar në mënyrë që të sigurojë konfiskimin e pasurisë së bërë nga kryerja e aktiviteteve kriminale por është dëshmuar të ketë vështirësi për shkak të frikësimit të dëshmitarëve apo arsyeve tjera që mund të ndikojnë në rezultatet efikase të sistemit gjyqësor.⁴² Ligji përshkruan në detaje përgjegjësinë e gjyqtarëve në emërimin dhe monitorimin e punës së administratorëve të aseteve. Me anë të punës së tyre ata gjithashtu sigurojnë kontrollin dhe balancimin e përfshirjes qeveritare (Këshillit të Ministrave) në procesin e konfiskimit të aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme. Një gjyqtar në gjykatën e nivelit të parë të krimeve të rënda vendos për kërkesën e prokurorisë në lidhje me sekuestrimin e aseteve, ndërsa trupi gjyqësor, i përbërë nga tre gjyqtarë, vendos për konfiskimin e aseteve.⁴³ Bartja e përgjegjësisë për ofrim të dëshmimeve është e lejuar, me ç'rast i takon të dyshuarit të dëshmojë prejardhjen e pasurisë. Seanca e shpalljes së aktgjykimit bëhet në përputhje me kodin e procedurës civile. Ligji përshkruan në detaje rastet në të cilat mund të bëhet konfiskimi, dhe e përcakton periudhën e sekuestrimit në më së shumti një vit. Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka iniciuar një rast në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar që ky ligj është në kundërshtim me Kushtetutën Evropiane dhe Konventën e të Drejtave të Njeriut (ECHR). Gjykata kushtetuese vendosi që ligji nuk përbën shkelje të të drejtave të njeriut.⁴⁴ Përveç tjerash, interesi publik në luftimin e trafikimit dhe krimit të organizuar e bën të mundur që Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë⁴⁵ të urdhërojë këto masa.

⁴¹ Ligji mbi Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë, Ligji nr. 10 192

⁴² Alan Bacarese, Projekti Kundër Korrupsionit në Shqipëri (PKKS), Punim Teknik, Analizë Krahasuese mes Nenit mbi Konfiskimin në Kodin Penal Shqiptar dhe Neneve të Ligjit të ri Anti-mafia të Shqipërisë mbi Konfiskimin Civil, dhe aplikueshmërinë e tyre në lidhje me krimet e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Këshilli i Evropës dhe Instituti i Bazelit për Qeverisjen. Prill 2010.

⁴³ Ligji Shqiptar mbi Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë, Ligji nr. 10 192, Neni 7.

⁴⁴ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë Nr. 4, 23.02.2011 at <http://www.gjk.gov.al/>. dhe 'Gjykata Kushtetuese legalizon ligjin Anti-mafia' në <http://www.top-channel.tv/artikull.php?id=204806>, i qasur me 24 mars, 2011.

⁴⁵ Ligji Shqiptar Anti-mafia rregullon krimin e organizuar dhe trafikimin me njerëz. Më kërkesën e prokurorit gjykata vendos për sekuestrimin e aseteve të personave, sipas Nenit 3 të Ligjit Anti-mafia. Prokuroria kërkon sekuestrimin nëse ekziston dyshim i bazuar se personi i dyshuar ka qenë i përfshirë në aktivitete kriminale dhe prona e poseduar nga ai ose pasuria qëndrojnë në shpërpjesëtim me të ardhurat e tij apo të hyrat nga aktivitetet tjera të ligjshme. Nëse ekziston dyshimi se fitimet e krijuara nga aktivitetet kriminale mund të humben,

4.2 Italia

Mekanizmat ligjore dhe institucionale të Italisë janë mjaft të avancuara në mënyrë që të jenë përpara grupeve mafioze që janë shumë të përhapura dhe shumë mirë të organizuara. Që nga fillimi i viteve '80, kur u krijua edhe Guardia di Finanza, Italia ka amandamentuar ligjet e saj duke dhënë mundësi më të sofistikuar me synim që të ketë sukses në luftimin e krimit të organizuar, në veçanti konfiskimin e aseteve. Ligji 575/1965 mundëson konfiskimin e aseteve që vijnë nga aktivitetet kriminale, përmes procedurës civile. Më tej, përgjegjësia për ofrim të dëshmimeve bie në të dyshuarit, meqë ata duhet të dëshmojnë se asetet i kanë fituar në mënyrë të ligjshme. Meqenëse konfiskimi i pasurisë mund të bëhet para fillimit të gjykimit dhe është i ndarë nga akuzat, Guardia di Finanza ka rritur kapacitetet kërkuese administrative në mënyrë që të bëjë kërkime në pronën e poseduar, të hyrat e gjeneruara dhe të gjurmohet kalimin e aseteve nga njëri person te tjetri, që t'ua mundësojë prokurorëve kombëtarë kundër mafias, drejtorit të njësisë së hetimeve kundër mafias apo drejtorit të policisë kompetente administrative të kërkojë në gjyq sekuestrimin e pasurisë. Gjatë vitit 2010, autoritetet italiane kanë konfiskuar⁴⁶ asete në vlerë prej 15 miliardë euro, që dyshohet të jenë të poseduara nga mafia.

4.3 Kroacia

Në mesin e vendeve të para në rajon, kah viti 2001, Kroacia themeloi Zyrën për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si pjesë e Zyrës speciale të Prokurorit Publik. Kjo zyre ka qenë e autorizuar për zhvillim të hetimeve mbi grupet e krimit të organizuar dhe sekuestrimit të përkohshëm ose të përhershëm të aseteve nëse ato asete përbëjnë fakte për veprën penale të kryer apo nëse janë fituar përmes kryerjes së veprave penale. Sekuestrimi i aseteve është rregulluar me kodin penal dhe ligjin e procedurës penale. Këto lehtësira iu kanë mundësuar autoriteteve të konfiskojnë fitimet që ishin në shpërpjesëtim. Amandamenti i Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale gjatë vitit 2008 ka kontribuar në forcimin e USKOK. Amandamentet gjithashtu kanë paraparë edhe bartjen e përgjegjësisë për ofrim të dëshmimeve në anën e kundërt për rastet që hetohen nga USKOK, pasi që ai që mbrohet është përgjegjës të ofrojë dëshmi për prejardhjen e pasurisë së tij.⁴⁷ Sipas raportit të Departamentit

prokurori shtetëror mund të urdhërojë konfiskim të përkohshëm. Në veçanti, kur ekziston dyshimi se celula të krimit të organizuar qëndrojnë pas pronave apo fitimeve, ligji lejon edhe këtë lloj konfiskimi. Kërkesa e prokurorit shtetëror për sekuestrim bazohet në indeksin e dyshimeve të arsyetuara. Neni 3 i Ligjit Shqiptar mbi Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë.

⁴⁶ Adnkronos. *Itali: Policia Anti-mafia bën konfiskimin "më të madh ndonjëherë" të aseteve jashtë Campina -s*. Në <http://www.adnkronos.com/IGN/Aki/English/Security/?id=3.1.1790732662>, i qasur me 13 prill, 2011.

⁴⁷ Departamenti i Shtetit të SHBA-ve. *2011 Deklarata për Klimën e Investimeve – Kroaci*. Mund të gjendet në <http://www.state.gov/e/eeb/rls/othr/ics/2011/157264.htm>, i qasur me 14 prill, 2011

të Shtetit të SHBA-ve,⁴⁸ këto ndryshime kanë pasur ndikim pozitiv në zvogëlimin e ngarkesës në punë, duke rritur numrin e rasteve dhe efikasitetit me të cilin vepron USKOK.

Një prej parakushteve për të qenë të suksesshëm në konfiskimin e aseteve kriminale është zhvillimi i një kornize të përshtatshme ligjore. Për shkak të rrethanave specifike në çdo vend, dispozitat duhet të adaptohen brenda kontekstit duke përfshirë këtu edhe bartjen e përgjegjësisë për ofrim të dëshmive tek i dyshuari që ka përfituar nga korrupsioni ose krimi i organizuar, si dhe emërimin e njësive speciale të prokurorëve dhe hetuesve në mënyrë që të mundësohet aplikimi i teknikave speciale hetimore. Disa vende si Italia kanë inkorporuar kapacitete administrative hetimore bashkë me komponentin e ndjekjes. Administrata tatimore dhe njësia e inteligjencës financiare kanë kompetenca për identifikim të aseteve që kanë prejardhje të dyshimtë. Prandaj, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të ndryshme është jashtëzakonisht i rëndësishëm.

Konteksti socio-ekonomik dhe i sundimit të ligjit në një vend luan rolin kryesor në mënyrën se si duhet të zbatohet konfiskimi. Edhe pse ekzistojnë, dispozitat e tanishme të Kosovës nuk po ia dalin të sigurojnë reagim efektiv ndaj aktiviteteve kriminale pasi që sistemi gjyqësor vazhdon të jetë i brishtë dhe gjithandej ekziston korrupsioni që përfshin edhe zyrtarë të lartë, që ndikohet nga ekonomia joformale shume e përhapur dhe sundimi i dobët i ligjit. Pjesa e mëposhtme analizon këto kapacitete më thellësisht.

5. KAPACITETET E TANISHME NË IDENTIFIKIMIN E PASURISË SË FITUAR NË MËNYRË TË KUNDËRLIGJSHME

Korniza e tanishme ligjore e Kosovës është e dobët në reagim ndaj rasteve komplekse të korrupsionit që përfshijnë edhe rastet e ndjeshme të zyrtarëve të lartë. Mbrojtja e dëshmitarëve vazhdon të jetë çështje e rëndësishme në rastet e ndryshme, përfshirë ato të krimit të organizuar për shkak të territorit të vogël të Kosovës dhe frikësimit të dëshmitarëve.⁴⁹ Legjislacioni për mbrojtjen e dëshmitarëve ende nuk ka hyrë në fuqi. Prandaj, në mënyrë që të forcohet korniza ligjore, duhet të bëhen shqyrtimet e nevojshme të ligjit, të cilat do të pasoheshin nga ofrimi i burimeve adekuate njerëzore dhe buxhetore për të siguruar se përpjekjet aktuale do të jenë efektive në luftimin e suksesshëm të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Çfarëdolloj ndërhyrje politike, siç është vendimi i Kryeministrit të Kosovës për të formuar Task-Forcën Kundër Korrupsionit në kuadër të ZPSK, duhet të shmanget. Vullneti politik ka dështuar në forcimin e mekanizmave të tanishëm, kryesisht

⁴⁸ Ibid.

⁴⁹ Raporti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, 26 janar 2011 mbi 'Mbrojtjen e dëshmitarëve si gur-themel për drejtësinë dhe pajtimin në Ballkan,' në <http://assembly.coe.int/Documents/WorkingDocs/Doc10/EDOC12440.pdf>

duke parandaluar punën efektive të prokurorëve, agjencive për zbatimin e ligjit dhe gjyqtarëve.

Në Kosovë prokurorët, hetuesit dhe gjyqtarët kanë mungesë të njohurive mbi mënyrën se si operojnë grupet kriminale brenda dhe jashtë Kosovës.⁵⁰ Një ligj anti-mafia do të përbënte vështirësi edhe më të mëdha në definimin dhe evidentimin para gjyqit të ekzistencës së grupeve mafioze. Mundësitë ekzistuese deri më tani nuk janë shfrytëzuar plotësisht në luftimin e krimit të organizuar, me prokurorë dhe gjyqtarë kosovarë të cilëve iu mungon mbështetja adekuate financiare, mbrojtja, dhe siguria e vendit të punës për të ndërmarrë masa të tilla.⁵¹ Qeveria kosovare deri më tani ka bërë përpjekje që janë më shumë të orientuara kah përmirësimi i marrëdhënieve me publikun sesa kah reformat e vërteta përmbajtjesore. Vetëm nga fillimi i vitit 2011, gjyqtarëve dhe prokurorëve kosovarë ju është ofruar rritja e pagës dhe kontratat e përhershme. Neglizhenca ka vazhduar me vendosjen e paradokohshme të Njësisë së Inteligjencës Financiare në kuadër të Ministrisë së Financave, gjë që mund të komprometojë pavarësinë politike të një institucioni aq të rëndësishëm.⁵² Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar është ende në fazat e saj fillestare, duke mos pasur ende madje as hapësirën e nevojshme për zyrat e personelit të Agjencisë.⁵³

Për shkak të kohës dhe burimeve njerëzore e financiare të kufizuara, zyrat prokuroriale nuk janë në gjendje të hetojnë gjithçka që duket të jetë e dyshimtë por duhet të caktojnë prioritetet e tyre duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut. Personat përgjegjës në Kosovë nuk kanë hartuar raportet e duhura të analizës së rreziqeve nga korrupsioni dhe aktivitetet e krimit të organizuar, të cilat do të përmbanin informata të detajuara mbi funksionimin e grupeve/klaneve të caktuara të cilat zhvillojnë aktivitete kriminale në Kosovë. Si pasojë, ekziston mungesë e iniciativës nga prokurorët për zhvillim të hetimeve në fushat më të ndjeshme. Për shembull, disa raporte të publikuara nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) vënë në pah aktivitete të dyshimta prokurimi. Prokurorët nuk kanë një vlerësim i cili do të mund të identifikonte procedurat më të rrezikshme dhe në të njëjtën kohë mënyrat më të mira për mbledhjen e fakteve mbi ato raste. Njohuritë e hetuesve dhe prokurorëve mbi aktivitetet kriminale në Kosovë mbesin shumë të kufizuara dhe nuk janë të institucionalizuara. Për më tepër, kjo paraqet një problem për hetuesit dhe prokurorët ndërkombëtarë që janë pjesëtarë të misionit të EULEX-it. Hetuesit dhe prokurorët ndërkombëtarë kanë njohuri dhe teknika 'objektive' për zhvillim të hetimeve profesionale.

⁵⁰ Intervista me Kryetaren e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Maria Guliana Civinini dhe hetuesit e EULEX-it, mars 2011.

⁵¹ Intervista me Prokurorin Special të Kosovës, mars 2011.

⁵² Intervista me zyrtarë qeveritarë dhe të EULEX-it, mars-prill 2011.

⁵³ Intervista e KIPRED-it me një gazetar të specializuar për çështjet gjyqësore, prill 2011.

Sidoqoftë, atyre iu mungojnë njohuritë ‘subjektive’, që janë të lidhura me të kuptuarit e kulturës së shoqërisë kosovare, mentalitetit të qytetarëve, mënyrës se si i zhvillojnë aktivitetet e tyre grupet kriminale, dhe kapacitetet e inteligjencës për të dëshmuar lidhjet e mundshme në mes të akterëve kriminalë dhe atyre politikë.

Pavarësisht dispozitave ligjore të dobëta dhe jo mirë të detajuara, brengë të madhe paraqet fakti se deri më tani nuk ka pasur iniciativa konkrete nga prokurorët në konfiskimin e aseteve të fituara përmes aktiviteteve kriminale. Një prokuror special thotë se prokurorët kanë hezitar të përfshijnë konfiskimin e aseteve si pjesë e akuzës kryesisht për shkak se kanë qenë të frikësuar. Ata kryesisht mbështeten në homologët e tyre në EULEX për ta bërë këtë gjë. Kjo ‘varshmëri’ nga homologët ndërkombëtarë, krijon një vakuum në reagimin ndaj kimit të organizuar dhe rasteve të korrupsionit. Prokurorëve specialë në përgjithësi nuk iu është ofruar siguri në punë përmes mbrojtjes më të mirë fizike, pagave adekuate, përkrahjes administrative, mbrojtjes për familjet e tyre, zyrave adekuate, dhe kushteve tjera elementare për përmbushjen e mandatit të tyre.

Në shumë vende tjera, përfshirë këtu Italinë, Agjencia për Administrim të Tatimeve konsiderohet të jetë institucion kyç në zhvillimin e hetimeve administrative dhe identifikimin e aseteve të cilat janë fituar përmes zhvillimit të aktiviteteve kriminale. Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) në këtë drejtim mbetet joefektive pasi që tregu i zi përbën 50% të tregut.⁵⁴ ATK nuk ka asnjë rol në zhvillimin e hetimeve administrative mbi atë se si kanë krijuar individët pasurinë e tyre.

Qendra për Inteligjencë Financiare (QIF), pjesë e EULEX-it, ka analizuar raportet e lëshuara nga bankat dhe institucionet tjera financiare, me fokus të veçantë në shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit. QIF përbëhet nga personeli lokal dhe ndërkombëtar, i cili aktualisht është duke u transferuar në institucionet kosovare. Natyra e punës së kësaj qendre është shumë e ndjeshme dhe ka pasur përplasje idesh ndërmjet akterëve lokalë dhe ndërkombëtarë rreth mënyrës më të mirë për të siguruar pavarësinë e kësaj qendre. Kompetencat e QIF do të barten tek Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF) e themeluar në kuadër të Ministrisë së Financave. Deri më tani, NJIF ka emëruar drejtorin e saj, por bartja e kompetencave është e ngadalshme pasi që personi kryesor mbetet një zyrtar i EULEX –it. Për shkak të natyrës së ndjeshme të punës së këtij institucioni, është thelbësore të sigurohet se ai do të mbetet i pacenuar nga ndërhyrjet politike, gjë që nuk mund të ndodhë me vendosjen e tij në kuadër të Ministrisë së Financave (MF). Prandaj, zgjidhja më e mirë do të mund të ishte vendosja e tij

⁵⁴ Abdullah Hoti. Determinantët e emigrimit dhe pasojat e tij ekonomike - *fakte nga Kosova*. Studime për Evropën Juglindore dhe Detin e Zi, vol. 9, nr. 4, 2009.

nën ombrellën e Autoritetit Qendror Bankar (AQB) ose Zyrës së Prokurorit. Kjo njësi mund të jetë organi kyç në identifikimin e transaksioneve të dyshimta dhe mbledhjen e të dhënave të rëndësishme që kanë të bëjnë me aktivitetet kriminale.

6. MENAXHIMI I ASETEVE TE SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA

Institucionet e ndryshme në Kosovë përfshirë këtu Gjykatat, Policinë e Kosovës (PK), Doganat, Administratën Tatimore, dhe Agjencinë për Ushqim dhe Veterinari (AUV) kanë mandate për konfiskim të mallrave, materialeve dhe pronës. Të gjitha këto institucione kanë hasur në probleme rreth menaxhimit të aseteve të konfiskuara gjë që ka rezultuar me krijimin e një institucioni të specializuar. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar (AAPSK) është në fazat fillestare të themelimit të saj pasi që është duke hartuar rregulloret e saj të brendshme dhe duke siguruar hapësirën e nevojshme fizike. Deri më tani, agjencia ka filluar me menaxhimin dhe shitjen e bagëtisë së konfiskuar përmes ankandit.⁵⁵ AAPSK është duke u përkrahur nga UK DFID dhe Ambasada e SHBA-ve në hartimin e legjislacionit sekondar dhe në krijimin e procedurave të dëshmuara si praktika më e mirë për bashkëpunimin ndërinstitucional, përcaktimin e vlerës, menaxhimin, shitjen, dhe proceset tjera të ndërlidhura me asetet.

AAPSK është themeluar kah qershori i vitit 2010 si pjesë e Ministrisë së Drejtësisë (MD),⁵⁶ një vit pas kalimit të ligjit mbi Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (APSK)⁵⁷. Mandati i AAPSK-ut është tërësisht administrativ dhe mes tjerash përfshin edhe këto përgjegjësi: menaxhimin, administrimin, dhe/ose shitjen e aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara.⁵⁸ AAPSK-u zbaton detyrat e veta në bashkëpunim të ngushtë me gjykatat, zyrat e prokurorëve, dhe institucionet tjera relevante. Deri më tani, procesi i hartimit të legjislacionit sekondar për operim funksional është zgjatur pasi që MD ka lëshuar vetëm një Udhëzim Administrativ që rregullon strukturën organizative të Agjencisë.⁵⁹

AAPSK është duke lëvizur shumë ngadalë drejt shndërrimit në një organizatë funksionale. AAPSK-u është duke u ballafaquar me probleme si mungesa e hapësirave punuese në objektet e Ministrisë së Drejtësisë dhe mungesa e një depoje ku do të mund të vendoseshin

⁵⁵ Intervista e KIPRED-it me personelin e Agjencisë, prill 2011.

⁵⁶ Ligji nr. 03/L-141 mbi Administrimin e Pasurisë të Sekuestruara dhe Konfiskuara

⁵⁷ Intervista e KIPRED-it me Z. Enver Krasniqi, u.d. i Drejtorit Ekzekutiv, Agjencia për Administrim të Pasurisë të Sekuestruara dhe Konfiskuara, 22 shkurt, 2011

⁵⁸ Ligji nr. 03/L-141 mbi Administrimin e Pasurisë të Sekuestruara dhe Konfiskuara, Neni 4.1

⁵⁹ Udhëzimi Administrativ nr. 1/2010, për strukturën organizative dhe funksionale të agjencisë për asete të sekuestruara dhe konfiskuara

asetet e sekuestruara ose konfiskuara siç është e paraparë më ligj.⁶⁰ AAPSK vetëm tani është duke finalizuar procesin e rekrutimit për 17 pozita të cilat janë aprovuar së fundmi nga MD.⁶¹ Personelit të tanishëm i mungon ekspertiza pasi që kjo është hera e parë që një agjenci e tillë po operon në Kosovë pas luftës.

Ligji mbi MASK parashih masa shumë të gjera dhe i mungon cilësia pasi që nuk përfshin praktikën më të mira dhe është i paqartë. Disa nga çështjet janë të lidhura me rolin e gjykatave gjatë administrimit të aseteve ku nuk parashihet përzgjedhja e një administratori të aseteve nga gjyqtari siç ndodhë në vendet tjera. Disbursimi i profiteve të gjeneruara nga shitja e aseteve të konfiskuara parashihet të shkojë direkt në buxhetin e Kosovës pa dhënë asnjë alternativë për kompensim të grupeve të marginalizuara ose grupeve që promovojnë të drejtat e njeriut dhe forcimin e sundimit të ligjit.

7. PËRFUNDIMI

Si përfundim, Kosova ka kapacitete të dobëta dhe të kufizuara ligjore dhe institucionale për të konfiskuar pronën e fituar në mënyrë të kundërligjshme. Mbetet shumë për tu bërë në tejkalimin e status quo-s aktuale për luftën efektive kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Sanksionimi dhe kompensim të viktimave dhe shoqërisë si tërësi nga disa individë dhe kriminelë që përfitojnë nga pasuria e fituar në mënyrë të kundërligjshme, mund të jetë një prej mënyrave për t'iu ofruar drejtësi qytetarëve dhe për të siguruar sundimin e ligjit në Kosovë. Kosova mund të përfitojë nga qasjet regjionale, duke krahasuar modelet e ndryshme dhe duke zhvilluar një kornizë ligjore e cila do të bënte të mundur reagimin efektiv në konfiskim të pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme. Në mesin e çështjeve të cilat duhet të ngriten fillimisht është ajo e përgjegjësisë për ofrim të dëshmimeve, ku të gjitha vendet e rajonit kanë filluar të aplikojnë bartjen e kësaj përgjegjësie tek pala e kundërt, në mënyrë që të zvogëlohet ngarkesa e punës dhe të lehtësohet procesi për organet e prokurorisë dhe zbatimit të ligjit në mbledhjen e fakteve për dëshmim të burimeve të pasurisë. Më tej, procedurat dhe mekanizmat e ndryshëm të angazhuar në hetimin e rasteve të korrupsionit dhe krimin të organizuar, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë, dhe administrimi i pasurisë së konfiskuar duhet të inkorporohen në një numër sa më të vogël ligjesh. Hartimi i ligjit të ri specifik për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar duhet të shihet si një opsion në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i paraqitjes së mospërputhjeve dhe shkeljeve të ligjit, hutimi

⁶⁰ Intervista e KIPRED-it me Z. Enver Krasniqi, u.d. i Drejtorit Ekzekutiv, Agjencia për Administrim të Pasurisë të Sekuestruara dhe Konfiskuara, 22 shkurt, 2011 dhe Udhëzimi Administrativ nr. 1/2010, për strukturën organizative dhe funksionale të agjencisë për pasuri të sekuestruara dhe konfiskuar, neni 2.5

⁶¹ Sipas Z. Enver Krasniqi, u.d. i Drejtorit Ekzekutiv, Agjencia për Administrim të Pasurisë të Sekuestruara dhe Konfiskuara, 15 persona janë rekrutuar deri më tani.

i gjyqtarëve dhe prokurorëve se cilat procedura duhet të aplikojnë, si dhe të promovohet bashkëpunimi në mes të institucioneve.

8. REKOMANDIMET:

Për Qeverinë e Kosovës:

Të hartojë një ligj mbi konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme. Ligji gjithashtu duhet të parasheh edhe bartjen e përgjegjësisë për ofrim të dëshmive tek shkelësi i ligjit, i dyshuar për rritje të pasurisë përmes aktiviteteve të kundërligjshme. Gjithashtu, menjëherë duhet të adresojë rastet në të cilat janë të përfshirë zyrtarë të lartë si raste komplekse dhe të ndjeshme.

Të amandamentojë Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale për të cilësuar si krim deklarimin e rremë të pasurisë nga ana e zyrtarëve publikë dhe politikanëve, duke rritur dënimet për deklarime të rrejshme.

Të hartojë ose amandamentojë ligjin e tanishëm mbi ZPSK, për ta bërë luftën kundër korrupsionit prioritet, e jo çështje të dorës së dytë. Ligjet specifike apo amandamentet nuk duhet të merren me masat e parandalimit por të përfshijnë luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në qëllimet e ligjit, pasi që kjo është një dukuri ekzistuese në Kosovë.

Administrata Tatimore e Kosovës duhet të bëhet një organizatë pro-aktive në identifikimin e pasurisë së gjeneruar përmes burimeve të dyshimta, përmes evazionit tatimor ose mashtrimeve, duke amandamentuar mandatin e tyre pas vlerësimit të nevojave.

Ministria e Drejtësisë duhet t'i ofrojë më shumë mbështetje Agjencisë për Administrim të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara në mënyrë që të sigurojë hapësira adekuate për zyra dhe depo, si dhe të kompletojë legjislacionin sekondar për operim funksional.

Për Shërbimet Prokuroriale të Kosovës:

Të përmirësojnë evidentimin e rasteve të raportuara për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë përmes zbatimit të ligjit të aplikueshëm, posaçërisht në rastet e trafikimit me qenie njerëzore, ku shqiptohen verdikte penale.

ZPSK-së duhet t'i jepet pavarësi në punën e saj, dhe duhet të jetë e liruar nga ndërhyrjet që bëhen nga pushteti ekzekutiv. Prokuroria Shtetërore e Kosovës dhe Kryetari i ZPSK nga EULEX-i duhet të hartojnë një strategji për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të

organizuar në Kosovë, duke përfshirë këtu vlerësimin e detajuar të burimeve të nevojshme njerëzore dhe buxhetore.

Për EULEX-in:

EULEX-i dhe autoritetet e Kosovës duhet të zhvillojnë hetime të përbashkëta mbi aktivitetet e grupeve kriminale që operojnë në Kosovë, ku hetuesit ndërkombëtarë do të ofronin mjetet dhe ekspertizën për hetime komplekse përderisa hetuesit lokalë do të kontribuonin me njohuritë e tyre mbi operimin e grupeve kriminale në Kosovë.

9. REFERENCAT:

Kuvendi i Kosovës. Kodi Penal i Kosovës.

____. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.

____. Ligji për Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë, Ligji nr. 03/L-151.

____. Ligji për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, Ligji nr. 03/L-141.

____. Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-052.

Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit. “Raporti Vjetor 2010.” 2010.

Komisioni i Komuniteteve Evropiane. “Raporti i Progresit për Kosovën (nën UNSCR 1244/99) 2010.” Nëntor 2010.

Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. “Raporti për punën e Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial.” Tetor 2010.

Nations in Transit. Nga Ilir Deda. “Raporti për Kosovën 2010.”

Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Rregullorja 2001/04 mbi Ndalimin e Trafikimit me Njerëz në Kosovë.

Kombet e Bashkuara. Konventa e Kombeve të Bashkuara e 12 dhjetorit 2000 kundër krimit të organizuar tej-nacional.

Këshilli i Bashkimit Evropian. Vendimi i Kornizës Punuese të Këshillit 2005/212/JHA i 24 shkurtit 2005 mbi Konfiskimin e Fitimit të ndërlidhur me Krimin. Instrumentet dhe Fitimet, Mars 2005.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. “Raporti për Aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë gjatë vitit 2009.” Shkurt 2010.

Parlamenti i Republikës së Shqipërisë. Ligji Shqiptar mbi Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë, Ligji nr. 10 192.

Këshilli i Evropës dhe Instituti i Bazelit për Qeverisje. Nga Alan Bacarese. “Analizë krahasuese mes neneve mbi konfiskimin në Kodin Penal Shqiptar dhe neneve të ligjit të ri anti-mafia të Shqipërisë mbi konfiskimin civil, dhe aplikueshmërinë e tyre në lidhje me krimet e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.” Prill 2010.

Departamenti i Shtetit të SHBA-ve. “Deklarata për klimën e investimeve 2011– Kroacia.”

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës. “Mbrotjtja e dëshmitarëve si gur-themel për drejtësinë dhe pajtimin në Ballkan.” Janar 2011.

Studime për Evropën Juglindore dhe Detin e Zi. Nga Abdullah Hoti. “Determinantët e emigrimit dhe pasojat e tij ekonomike: fakte nga Kosova.” 2009.

Ministria e Drejtësisë. Udhëzimi Administrativ nr. 1/2010, për strukturën organizative dhe funksionale të agjencisë për pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

332.27(047)

Fuqizimi i sundimit të ligjit II : konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme / [përgatitur nga Ariana Qosaj-Mustafa dhe Adem Gashi. – Prishtinë : KIPRED, 2011. – 26 f. ; 30 cm.

Lista e shkurtesave : f. 4. - Referencat : f. 26

1.Qosaj-Mustafa, Ariana 2. Gashi, Adem

ISBN 978-9951-14-032-4